



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 888/24, Datë: 10.05.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ.Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 122-të, mbajtur me datë 22.04.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht kërkesa e Kolegjit UBT kampusi kryesor, nr. 444/24 e datës 04.03.2024 dhe pranohen aplikacionet për programet:
 1. *Politika Publike dhe Menaxhim, MSc 120 ECTS (Riakreditim)*
 2. *Farmacë, MPH, 300 ECTS (Riakreditim)*
- II. Anulohet pika 7 dhe pika 9 e paragrafit I të vendimit Ref.:583/24 i datës 26.03.2024.
- III. Njoftohet IAL për vazhdimin e procedurave të akreditimit për programet si në paragrafin I.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Agjencia e Kosovës për Akreditim (tutje AKA), me datë 04.03.2024 ka pramuar kërkesë nga Kolegji UBT kampusi kryesor nr. 444/24 për rishqyrtim të vendimit Ref.:583/24 të datës 26.03.2024 me pretendimin për disa lëshime teknike dhe procedurale gjatë shqyrtimit të lënëve për ri/akreditim.

Të dhënat janë prezantuar në mbledhjen e 122-të, mbajtur me datë 22.04.2024, dhe pas shqyrtimit të detajuar të aplikacionit/kërkesës, verifikimit të dokumentacionit relevant të kualifikimit për secilin staf akademik të programit të studimit, KShC mori vendim si në dispozitiv.

1. Për programet Politika Publike dhe Menaxhim, MSc 120 ECTS (Riakreditim) KShC në mbledhjen 120 kishte vendosur që të refuzohet ky program, me arsyetimin se: Pas verifikimit të dokumentacionit për stafin akademik, KShC ka vërtetuar se bartësja; Shqipe Mjekiqi e propozuar për programin; Politika Publike dhe Menaxhment, MA, 120 ECTS, nuk është e përshtatshme sipas dispozitave ligjore sepse e njëjta, sipas të dhënave ka dy kontrata të rregullta.

Faqe 1 nga 2

Mirëpo Kolegji UBT në kërkesën për rishqyrtim ka ofruar dëshmi bindëse me të cilat është vërtetuar se bartësja e propozuar Shqipe Mjekiqi, ka vetëm një marrdhënie të rregullt punë dhe atë vetëm me Kolegjin UBT dhe rrjedhimisht i plotëson kriteret ligjore për të qenë bartëse e programit *Politika Publike dhe Menaxhim, MSc 120 ECTS*.

2. Për programin e studimit: Farmaci, MPH, 300 ECTS; KShC në mbledhjen 120 kishte vendosur që të refuzohet ky program, me arsyetimin se: Pas verifikimit të dokumentacionit për stafin akademik të propozuar nga Kolegji UBT, KShC ka vërtetuar se bartësit e propozuar; Arianit Jakupi - PhD në Menaxhment, Eda Mehmeti - PhD në Shkenca Natyrore, Fidan Feka PhD në "Proceset e trajtimit kimik të lëndëve të para natyrore dhe mbetjeve industriale urbane" dhe Hyrie Koraqi PhD në Kimi nuk janë të fushës së programit të studimit.

Ndërsa bartësit: Bujar Qazimi - PhD në Farmaci, Shpend Dragusha - PhD në Farmaci dhe Valon Ejupi - PhD në Farmaci nuk kanë të publikuara punime të nevojshme të përcaktuara me paragrafin 5, nënparagrafët 5.2 të Manualit të akreditimit (përditësuar me vendimin Ref.932/22).

Mirëpo Kolegji UBT në kërkesën për rishqyrtim ka ofruar dëshmi bindëse me të cilat është vërtetuar se bartësit e propozuar Bujar Qazimi - PhD në Farmaci, Shpend Dragusha - PhD në Farmaci dhe Valon Ejupi - PhD në Farmaci; kanë të publikuara punimet e nevojshme të përcaktuara me manualin e akreditimit dhe pas verifikimit të linqeve të bashkëngjitura KShC ka verifikuar vërtetësinë e publikimeve dhe ka konstatuar se bartësit Bujar Qazimi - PhD në Farmaci, Shpend Dragusha - PhD në Farmaci dhe Valon Ejupi - PhD në Farmaci i plotësojnë kriteret ligjore për të qenë bartës i programit Farmaci MPH 300 ECTS.

Andaj KShC bazuar në faktet e prezantuara, verifikimin e të dhënave dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë (Nenin 26, pika 5.3.4 të UA për Akreditim dhe Manualit të akreditimi (përditësuar me vendimin Ref.932/22), pas administrimit të provave dhe gjendjes së vërtetuar faktike dhe juridike vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji UBT;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

